



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 21

Tiranë – E hënë, 3 qershor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. 987, datë 24.5.2019	Për delegim kompetence..... 3
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, nr. 1624, datë 27.5.2019	Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit “Fermer Trade”..... 3
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, nr. 1625, datë 27.5.2019	Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit “Colombo sh.p.k.”..... 5
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, nr. 1626, datë 27.5.2019	Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit “Fed Invest”..... 6
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, nr. 1653, datë 30.5.2019	Për botimin e vendimeve për dënim administrativ, ndaj subjektit “M.S.S.C” dhe “Qendra Shëndetësore Kamëz”..... 7
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, nr. 1671, datë 31.5.2019	Për botimin e vendimeve për dënim administrativ, ndaj subjektit “Elis Lika”..... 8

**URDHËR****Nr. 987, datë 24.5.2019****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 28, gërma “d” e ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në funksion të mbarëvajtjes të veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për të trajtuar dhe nënshkruar shkresat me karakter njohës dhe informues, sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë, drejtorëve të njësive në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së, si vijon:

- Drejtorit të Njesisë së Titujve të Pronësisë, z. Eljon Semanaj;
- Drejtorit të Njesisë së Kadastrës dhe Hartografisë, z. Andi Proko;
- Drejtorit të Njesisë Juridike dhe të Kontrollit, zj. Jeta Velaj;
- Drejtorit të Njesisë së Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, zj. Brikena Dervishaj.

2. Shkresat informuese të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, që u drejtohen të tretëve (persona fizikë, persona juridikë privatë dhe publikë), si dhe ato drejtuar strukturave të varësisë të ASHK-së, në funksion të informimit të të tretëve, të nënshkruhen nga drejtorët e Njësive të përmendur në pikën 1 të këtij urdhri, sipas detyrave funksionale dhe përgjegjësisë të secilës njësi.

Përfshirë, shkresat që i drejtohen Presidentit të Republikës, Kryeministrit, ministrave, sekretarëve të përgjithshëm të ministrive, si dhe kryetarëve të bashkive, nënshkruhen nga Drejtori i Përgjithshëm.

3. Delegimi i kompetencës sipas këtij urdhri, nuk përfshin aktet dhe shkresat me karakter vendimmarrës. Shkresat që trajtojnë problematika, mosmarrëveshje administrative, apo civile, ose që kërkojnë nxjerrjen e akteve administrative/kryerjen e veprimeve administrative, nënshkruhen nga Drejtori i Përgjithshëm.

4. Pavarësisht delegimit të kompetencave sipas këtij urdhri, Drejtorët e njësive, nëse e gjykojnë të nevojshme, mund t'i përcjellin për këshillim apo nënshkrim Drejtorit të Përgjithshëm, shkresat me natyrë informuese që ata i vlerësojnë të rëndësishme të veçantë.

5. Në rast mungese në detyrë të subjekteve të përmendur në pikën 1 të këtij urdhri, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës, në kuptim të nenit 29, pika 2, gërma “ç” të “Kodit të Procedurave Administrative”.

Gjatë mungesës, kompetenca ushtrohet nga Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së.

6. Ngarkohen njësitet dhe drejtuesit e tyre të përmendur në pikën 1 dhe sektori i Arkivës dhe Protokollit, në Drejtorinë e Përgjithshme, për zbatimin e këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 547, datë 10.5.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Artan Lame

KËRKESË**Nr. 1624, datë 27.5.2019****PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR
DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ
SUBJEKTIT “FERMER TRADE”**

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

- “FERMER TRADE”

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Elvisjon Salku



VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-TR-2019-000304-5

Datë: 10.5.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit nr. ISHMPUT-TR-2019-000304-2, datë 16.4.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin FERMER TRADE, NIPT K92302031C, përfaqësues i autorizuar i subjektit Murat Klobocishta (Administrator), prej datës 10.4.2019, ora 09:00 deri më datën 10.4.2019, ora 16:00.

Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 16.4.2019 dhe e njoftoi në datën 16.4.2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 10463, datë 22. 9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", neni 62, pika 4.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve ", datë 4.16.2019, nenit/neneve 62, pika 4. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti pranë ISHMPUT-së Tiranë me nr. 695 prot., më datën 18.4.2019, rezultoi se mungonin dokumentat e transferimit të mbetjeve dhe kontrata me subjekt të licensuar. Në deklaratën e tij, subjekti shprehet se i trajton vetë mbetjet e veta, gjë kjo, e cila bie në kundërshtim me ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, neni 62, pika 3, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

- Gjobë 500 000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm.

Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:

- Menaxhimi dhe plotësimi i dokumentacionit të menaxhimit të mbetjeve sipas legjislacionit në fuqi.

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Gerson Tafa ID: 0301020014

Gezim Ruci ID: 0301020015

Ueda Damjani ID: 0301020034

Kundër Vendimit Përfundimtar, subjekti FERMER TRADE ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërrave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.

**KËRKESË****Nr. 1625, datë 27.5.2019****PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR
DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ
SUBJEKTIT “COLOMBO SHPK”**

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimin përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

- “COLOMBO SHPK”

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DE TYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Elvisjon Salku

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-TR-2018-000083-5

Datë: 21.1.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit nr. ISHMPUT-TR-2018-000083-2, datë 21.12.2018, inspektim, që është zhvilluar në subjektin COLOMBO, NIPT K36608208V, punëdhënës Petrit Leventi, prej datës 21.12.2018, ora 09:00 deri më datën 21.12.2018, ora 15:00.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 21.12.2018 dhe e njoftoi në datën 21.12.2018.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, 29, 1/b/ii,

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 10448, datë 7.14.2011, nenit/neneve 29, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

- Gjobë 300 000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

- Plotësimin e dokumentacionit të munguar dhe paraqitjen e tyre pranë ISHMPUT-së Tiranë.

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Genci Hicka ID: 0301020016

Eni Guce ID: 0301020026

Kundër Vendimit Përfundimtar, subjekti COLOMBO ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.

**KËRKESË****Nr. 1626, datë 27.5.2019****PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR
DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ
SUBJEKTIT “FED INVEST”**

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

- “FED INVEST”

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DE TYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Elvisjon Salku

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-TR-2019-000001-5

Datë: 21.1.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit nr. ISHMPUT-TR-2019-000001-2, datë 4.1.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin FED INVEST, NIPT K82923207C, punëdhënës Elvis Sinani, prej datës 4.1.2019, ora 10:00 deri më datën 4.1.2019, ora 14:00.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 4.1.2019 dhe e njoftoi në datën 4.1.2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", neni 32, pika 1/e,

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", datë 1.4.2019, nenit/neneve 32, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

- Gjobë 5 000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

- Pezullim të pjesshëm të aktivitetit të pajisjeve zhurmëprodhuese deri në marrjen e masave për mbrojtjen e zhurmave.

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Ardit Bubeqi ID: 0301020010

Jetnor Zhelegu ID: 0301020017

Kundër Vendimit Përfundimtar, subjekti FED INVEST ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.

**KËRKESË****Nr. 1653, datë 30.5.2019****PËR BOTIMIN E VENDIMEVE PËR
DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ
SUBJEKTIT “M.S.S.C” DHE
“QENDRA SHËNDETËSORE KAMËZ”**

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

- “M.S.S.C”**- “QENDRA SHËNDETËSORE KAMËZ”**

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Elvisjon Salku

VENDIM**Nr. 886, datë 1.2.2019****I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të VKM-së nr. 103, datë 4.2.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, i ndryshuar, me vendimin nr. 694, datë 10.11.2017 të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me **Nr. 000032-5, datë 25.10.2018, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë**, ndaj subjektit **“QENDRA SHËNDETËSORE KAMËZ”**, protokolluar me nr. 6636 prot., datë 26.11.2018,

Komisioni:

Sa më sipër, nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët, arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me pikën 1/b/iii, të nenit 29, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2007 “Për lejet e mjedisit”, pasi shqyrtoi ankesën e subjektit dhe masën administrative në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit të dënimit nr. 000032-5, datë 25.10.2018, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë, në vlerën 30 000 lekë, dhe rrëzimin e ankimit të subjektit “QENDRA SHËNDETËSORE KAMËZ” ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
Armando LAMAJ

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.



VENDIM
Nr. 997, datë 1.2.2019

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të VKM-së Nr. 103, datë 4.2.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, i ndryshuar me vendimin Nr. 694, datë 10.11.2017 të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me **Nr. 5, datë 17.10.2018, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë**, ndaj subjektit **“M.S.S.C” shpk**, protokolluar me nr. 5664 prot., datë 24.10.2018,

Komisioni:

Sa më sipër, nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët, arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me gërmën “a”, të pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi ankesën e subjektit dhe masën administrative, në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit të dënimit nr. 5, datë 17.10.2018, në vlerën 30 000 lekë, dhe pezullimin plotësisht të aktivitetit deri në pajisjen me leje mjedisi dhe rrëzimin e ankimit të subjektit ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
Armando LAMAJ

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

KËRKESË
Nr. 1671, datë 31.5.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMEVE PËR
DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ
SUBJEKTIT “ELIS LIKA”

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

- **“ELIS LIKA”**

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Elvisjon Salku



VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-TR-2019-000372-5

Datë 30.4.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit nr. ISHMPUT-TR-2019-000372-2, datë 18.4.2019, inspektimqë është zhvilluar në subjektin “Elis Lika”, me NIPT L72105053R, përfaqësues i autorizuar i subjektit Elis Lika, prej datës 18.4.2019, ora 11:00 deri më datën 18.4.2019, ora 15:00.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datë 18.4.2019 dhe e njoftoi në datë 18.4.2019. Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit, rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore: Ligji nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis", neni 32, pika “1/e”,

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", nenit/neneve 32, pika “1/e”, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Gjobë 5 000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

- Pezullim të pjesshëm të aktivitetit të pajisjeve zhurmëprodhuese deri në marrjen e masave për mbrojtjen e zhurmave.

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Ardit Bubeqi ID: 0301020010

Andi Dore ID: 0301020030

*Kundër Vendimit Përfundimtar, subjekti **Elis Lika** ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.*

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2019